



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.Nr.219/2021  
Datë: 28 korrik 2021

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Lindita Jakupi, Gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/05/2021/GJS-GJS-2021-004, të datës 7 qershor 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 28 korrik 2021, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- Lindita Jakupi**, Gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.2, paragrafi 2, pika 2.5, 2.13 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- Për këtë shkelje disiplinore Gjyqtares Lindita Jakupi i shqiptohet sanksion disiplinor **vërejtje publike me shkrim**.

**A r s y e t i m**

Paneli hetimor i themeluar me vendimi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.120/2021, të datës 30 prill 2021, për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/0205/2021/GJS-GJS-2021-004, të datës 7 qershor 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduara të Gjyqtares së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, znj.Lindita Jakupi. Sipas pretendimit të Autoritet Kompetent Gjyqtarja Lindita Jakupi ka bërë dy shkelje disiplinore si ish Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të cilat ka kërkuar nga KGJK-ja që të trajtohen: dështim në aplikimin e Kodit të Përkohshëm penal, neni 261, paragrafi 2, duke e vlerësuar faktin se i pandehuri akuzohej për këtë vepër penale të datës 02.12.2011, konstatohet se parashkrimi absolut i ndjekjes penale në lëndën P.nr.4253/13, duhet të ishte arritur me 02.12.2021, e jo siç e ka trajtuar gjyqtarja z. Jakupi me datë 02.12.2017, dhe mos futja e aktvendimit P.nr.4253/12, i datës 22.01.2019, në shkresat e lëndës e cila rrjedhimisht ka mbet si lëndë aktive e pa deklaruar, e pa përfunduar edhe gjatë shkarkimit më lëndë para Komisionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë në dhjetor të vitit 2019.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore KGJK me 28 korrik 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore ku morën pjesë Kryesuesja e Panelit Hetimor Gjyqtarja Mevlide Shabani dhe avokati i autorizuar nga subjekti i këtij hetimit disiplinor Fatlum Podvorica.

Kryesuesja e panelit hetimor në fjalën hyrës dhe përfundimtare ka deklaruar se hetimi disiplinor është bërë në bazë një kërkesë sipas detyrës zyrtare nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës drejtuar KGJK-së me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore duke pretenduar se Gjyqtarja Lindita Jakupi ka bërë dy shkelje disiplinore: mos aplikim të Kodit të Përkohshëm penal, neni 261, paragrafi 2, dhe mos futja e aktvendimit P.nr.4253/12, i datës 22.01.2019, në shkresat e lëndës e cila rrjedhimisht ka mbet si lëndë aktive e pa deklaruar, e pa përfunduar edhe gjatë shkarkimit më lëndë para Komisionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë në dhjetor të vitit 2019. Me tutje ka kërkuar nga KGJK që në bazë të fakteve dhe provave të mbledhura të vendos që në veprimet e gjyqtarës Lindita Jakupi a ka apo nuk ka shkelje disiplinore, siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent.

Avokati i autorizua i subjektit të hetimit disiplinor Fatlum Podvorica, në seancën dëgjimore ka deklaruar se Gjyqtarja Lindita Jakupi e kryen punën gjithmonë në mënyrë profesionale dhe kjo dëshmohet me atë se asnjëherë nuk ka qenë para Këshillit Gjyqësor të Kosovës për pretendime për ndonjë shkele eventuale disiplinore. Sipas avokatit Podvorica, Gjyqtarja Jakupi me nxjerrjen e aktvendimit P.nr.4253/13, të datës 22.01.2019, ka bërë lëshime teknike të cilat nuk ka pasur mundësi ti përmirësoj vet, ndaj të njëjtit aktvendim nuk është ankuar dhe dëmtuar askush. Në fjalën përfundimtare avokati Podvorica ka kërkuar nga KGJK-ja që Gjyqtare Lindita Jakupi të lirohet nga përgjegjësia disiplinore duke mare parasysh edhe gjendjen e saj shëndetësore në të cilën ndodhet tani.

Për ta vërtetuar këtë çështje KGJK administroi dhe vlerësoj këto prova: Njoftimin e gjyqtarit Sabit Sadikaj, gjyqtar- Gjykata Themelore ne Prishtine, drejtuar U.D. kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtine z. \_\_\_\_\_, me datë 29.03.2021; Njoftimin drejtuar \_\_\_\_\_ Kryetar i Gjykatës \_\_\_\_\_ i datës 06.04.2021 nga \_\_\_\_\_ U.D Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtine; Njoftimin drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kryetari i \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ i datës 07.04.2021; Kërkesen drejtuar Lindita Jakupit gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nga \_\_\_\_\_, zyrtar i autorizuar për procedura disiplinore e datës 07.04.2021; Kërkesën për inicimin të procedurës disiplinore e parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Themelore ne \_\_\_\_\_ 11.12.2020; Kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës \_\_\_\_\_ e datës 19.04.2021; Deklaratën e gjyqtarës Lindita Jakupi drejtuar kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës; Procesverbalin mbi dorëzim-pranim të lëndëve penale nga gjyqtarja \_\_\_\_\_ gjyqtarja Lindita Jakupi; Urdhëresën P.Nr.4253/13 e datës 01.02.2021, e lëshuar nga Gjykata Themelore ne Prishtine drejtuar Policisë se Kosovës - Stacionit Policore Veriu ne Prishtine, e lëshuar nga gjyqtari Sabit Sadikaj; Procesverbalin e shqyrtimit fillestar P.Nr. 4253/13 i datës 20.01.202; Procesverbalin e shqyrtimit fillestar P.Nr. 4253/13, të datës 15.05.2019 (procesverbal nga subjekti i hetimit); Urdhëresa për verifikim adresa P.m. 4253113, e datës 15.04.2019 (urdhëresë e lëshuar nga subjekti i hetimit); Flet dërgesa për dorëzim personal P.m. 4253/13, e lëshuar nga Gjykata Themelore ne Prishtine (ftese për shqyrtim gjyqësor për dU5.04.2019); Procesverbali i shqyrtimit fillestar P.Nr. 4253113 i datës 15.04.2015 (procesverbal nga subjekti i hetimit); Aktvendimin P.m. 4253/13, i datës 22.02.2019, i lëshuar nga Gjykata Themelore ne Prishtine (Aktvendim ky i marre nga subjekti i hetimit); Flet dërgesa për dorëzim personal P.m. 4253113, e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtine e datës 22.01.2016; Letër rreshtim i datës 07.03.2016 drejtuar stacionit Policore në Prishtine për lëndën P.m.4253/13; Urdhër arresti drejtuar stacionit Policore Jugu në Prishtinë lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtine, P.m.4253113, e datës 20.01.2016; Urdhëresa për kërkimin e të pandehurit dhe njoftimin e Gjykatës, drejtuar stacionit Policor Veriu në Prishtinë lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, P.m.4253113, i datës 10.07.2015; Aktakuzën e lëshuar nga Prokuroria Themelore ne Prishtine PPIIm.6258/2012 e datës 20.12.2013;

Njoftimi lidhur me urdhëresën P.m.4253113, i lëshuar me date 28.07.2015, nga Policia e Kosovës  
stacioni Deklaratën e datës 02.12.2011, e deklaruesit Kontratën  
mbi shitblerjen e banesës 02.12.2011 dhe Autorizimin e datës 15.11.2018.

Pas vlerësimit të këtyre provave të administruara dhe deklaratës subjekt i hetimit KGJK konstatoj se gjyqtarja ka nxjerr aktvendim lidhur me parashkrimin e veprës penale duke zbatuar gabimisht dispozitat e kodit penal. Këtë rrethane e ka konfirmuar vet gjyqtarja subjekt i hetimit.

Për veç kësaj është konstatuar se gjyqtarja aktvendimin P.nr.4253/12 ja ka dërguar vetëm prokurorisë ndërsa të akuzuarit dhe palës se dëmtuar nuk ju ka dorëzuar aktvendimi në fjalë. Aktvendimi P.nr.4253/12 nuk është ruajtur as në dosje të çështjes dhe gjithashtu lënda nuk është dorëzuar si e përfunduar në administratën e gjykatës. Gjyqtarja pavarësisht faktit se ka përfunduar çështje, e njëjta përsëri ka caktuar seancë për të cilën nuk ka pasur kusht qe të mbahet.

Duke qenë se dosja nuk është dorëzuar si lëndë e përfunduar, e njëjta lëndë i është ndarë pune një gjyqtari tjetër i cili ka caktuar seancën gjyqësore dhe pas deklaratës së prokurores se çështjes ka kuptuar se rasti është i përfunduar.

Mbi bazën e rrethanave të theksuara më sipër dhe të konstatuara në seancën dëgjimore KGJK, vlerëson se sjelljet e Gjyqtarës Lindita Jakupi në rastin konkret janë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.2, paragrafi 2, pika 2.5, 2.13 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KGJK i shqyrtoj me kujdes masat disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vlerësoj se në rastin e Gjyqtarja Lindita Jakupi masa **vërejtje publike me shkrim** është masë proporcionale në raport në shkeljen e bërë të gjyqtarit, gjendjen shëndetësore në të cilën ndodhet dhe se e njëjta do të shërbej si masë për disiplinimin e gjyqtarës dhe si preventive për të ardhmen.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, dhe paragrafi 2, pika 2.1, 2.4, dhe 2.5, të Ligjit nr.06/1-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.Nr.219/2021, datë: 28 korrik 2021**

Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Lindita Jakupi, Gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Arkivit.